



EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -

EKO KLUBI

"KUJTIM KRASNIQI"

1





♦ Të dashur lexues,

EC ka filluar publikimin e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Qendrës së Kompetencës "Kujtim Krasniqi" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).



FJALA E NATYRËS

Asgjë që shohim, nuk është ashtu siç duket, çdo gjë përbëhet nga diçka. Ajo diçka përbëhet nga disa njësi, deri aty ku syri i njeriut është i kufizuar e verbohet.

Dhe çdo gjë vjetrohët, zvogëlohet, derisa vjen një moment që asgjë s'mund të shikohet. Por si vallë, u formuan këto gjëra misterioze që çdo ditë po jetojmë? Nga natyra, sigurisht.

Natyra është e çuditshme, sa edhe e bukur. Natyra është botë me vete, ku në të ka gjëra për të zbuluar pafund. Natyra është një ndër pjesët më të rëndësishme të jetës sonë, është e pranishme në çdo aspekt të saj.

Është mëse e dukshme se ndërmjet njeriut dhe mjedisit egziston një lidhje fortë, duke krijuar gjithashtu një raport varsie mes tyre. Njeriu përfiton nga mjedisi. Gjithçka që konsumojmë janë dhuratë prej tij dhe hapësirat në të cilën jetojmë. Për aq kohë sa ne kujdesemi për mjedisin, po të njëjtin kujdes marrim prej tij.

Vjen një ditë kur rëndësia e mjedisit kuptohet më shumë së kurrë më parë. Pikërisht sot. Mjedisi pa njeriun duket se po merr frymë, mjedisi pa veprimtarinë njerzore ekziston.

Por... e vërteta është se nuk jetojmë dot pa mjedisin por as pa e dëmtuar nuk qëndrojmë. Nuk duhet të presësh pëmët, të ndërtosh pa fund ndërtesa, të përdorësh pa fund lëndët djegëse, nuk duhet ta ndotësh nëse vërtetë mendon për shëndetin tënd. Pasi që mjedisi është gjithçka dhe çdo gjë që na rrethon.

NJERIU, PËRBËNDSHI MË I MADH I TOKËS

Natyra ose ndryshe ajo që na mban gjallë, ajo që i jep të gjitha pasuritë dhe vlerat ushqyese tokës poashtu dhe njerzëve.


Eh! Dikur ishte një vend i pasur, një vend me vlera, një vend që jetonin specie, bimë dhe gjallesa të ndryshme. Ishte ai vend që çdo njeri do donte të jetonte. E sot, çfarë sot? Sot, ai vend i bukur e frytdhënës është shkatërruar.

E mendoni nga kush? Nga vet ne, ne që duam shumë nga ajo dhe nuk bëjmë asgjë për të. Ne! Ne që po vrasim veten me duart tona. Si mundet njeriu të vras vetën me duart e tij? Po e vret, dhe për më tepër spo vret vetëm veten por dhe tokën, e gjithë gjallesat që jetojnë në të.

Ku më shumë se gjysmën e bimëve dhe e kafshëve janë në zhdukje, nga ne, ne që po vrasim, ne që po e shkatrojmë pa e ditur që po e bëjmë. E si? Duke ndotur, duke shpyllëzuar dhe duke vrarë. Këto po ndikojnë në shkatërrimin e ajrit, tokës dhe njeriut.

Por s'është vonë! Asnjëherë nuk është vonë, çdo njeri duhet të vetëdijsohet dhe të kuptojë që jemi në rrezik dhe të filloj të ndikoj për mirë në mbrojtjen e mjedisit, poashtu të vetëdijësoj të tjerët në kujdesin e mjedisit.

SHKUMBIN HOXHA XI-4 – EKO KLUBI "KUJTIM KRASNIQI"



NATYRA ËSHTË ARTI MË I BUKUR QË MUND TË DËSHIROHET NË JETËN E NJERIUT.

NATYRA ËSHTË NJË MISTER TË CILIT S'MUND ASKUSH PËRPOS NJERIUT NUK MUND TI'A GJEJ ZGJIDHJEN.



ZOTI KRIJOI NJERIUN TA ÇMOJ NATYRËN, JO TA SHKATRROJ ATË.

NATYRA ËSHTË NJË ËNDËRR E PAFUNDME TË CILIN NJERIU PO E DËMTON.

TË HULUMTOSH NATYRËN ËSHTË Ë NGJASHME SI TË KËRKOSH YJET NË PAFUNDËSI SEPSE ATA TË RRËTHOJNË GJATË NATËS ASHTU SI TË RRËTHOJNË GJATË NATËS ASHTU SI TË RRËTHOJNË BUKURITË E NATYRËS GJATË DITËS.



MUHAMET KRASNIQI X-11- EKO KLUBI "KUJTIM KRASNIQI"



AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE EC MA NDRYSHE



EKO KLUBI "KUJTIM KRASNIQI"

RR. HABIB BERISHA, LAGJJA E MIRËDITËS, MALISHEVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".